

RILINDASI

Viti II - Nr:27

E diel, 8 korrik 2012

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni edhe online


www.shqiptarja.com

DOSJA PEKMEZI NE VJENE

Përplasjet me Gurakuqin, Konicën, dhe kryekonsullin Kral

Nga Pjeter Logoreci

Tuj lexue librin Komisia Letrare Shqipe në Shkodër me autor Tomor Osmanin, në faqen 35 lexova: Kryetar i Komisionit Letrar Shqipe u caktua nga Komanda ushtarake austriake Dr. Gjergj Pekmezi, i cili e kreu këtë detyrë nga data 24 shtator 1916 deri më 17 shtator 1917. Për largimin e Gjergj Pekmezit nga KLSH-ja ka dy njoftime të kundërta, të dyja të botuara në gazetën "Posta e Shqipërisë". Në nr. 89, të dat. 13 tetor 1917 shkruhej: "Marim vesh se i ndritshmi z. Dr. Gjergj Pekmezi, të cilin kryekomanda e ushtrisë e ka pasë emnue kryetar në Komisionin Letrar, ka njëkë dorë prej kësaj zyreje.....". Katër ditë ma vonë, më 17 tetor 1917 pas këtij njoftimi gazeta "Posta e Shqipërisë" jep një njoftim tjetër, që e kundërshton të parin, bërë nga vetë Gj. Pekmezi, ku thu-



Në foto: Gjergj Pekmezi dhe faksimile të tri dokumentave nga dosja e zbuluar në Vjenë

hej: "Dorëheqjen time e dhashë se s'kam qenë aspak i marrun vesh me vendimet e dhanuna përmbi ortografinë e gjuhës shqipe prej Komisionit Letrar, tue ndodhë për pushime në Vjenë....."

Mospërputhja në mes dy lajmeve për një periudhë kaq të shkurtër, e sidomos njoftimi i dytë nga vetë Pekmezi, më bani kurioz dhe më motivoj për me kërkue burimin e këtij lajmi dhe arsyes e dorëheqjes. Në dokumentat arkivore diplomatik (Diplomatia und Außenpolitik 1848-1918) të asaj periudhe gjindet një dosje, që sipër saj mban shkrimin: Affäre Pekmezi. Kisha ndigue që ma përpara që në mes Pekmezit dhe disa pjestarve të Komisionit Letrar kishte mospërputhje mendimesh persa i përket çështjeve teknike të gjuhës shqipe. Mënyra e vendosjes së tij në krye të Komisionit Letrar me komandim nga pala austriake, nuk ishte e dishrueshme për themeluesit e saj...

vijon në faqen 14-15

Shqiptarët e dëbuar, Çamëria plagët e një shekulli

Nga 1913 e deri më sot, fakte, histori, dëshmi, dokumente, foto, deklarime e personazhe të përfshira në këtë tragedji, roli i politikës dhe politikanëve...


Nga Arben Llalla

Në vitin 1994, Kryetari i Republikës së Shqipërisë i atëhershëm Prof.Sali Berisha ka shpallur 27 qershorin si ditën e gjenocidit grek ndaj popullsisë shqiptarë të Çamërisë, (Dita e Gjenocidit ndaj Shqiptarëve të Çamërisë nga Shovinizmi Grek).

Gjenocidi i tmerrshëm i filluar më 27 qershor 1944, ka rezultuar me 10,000 mijë të vrarë (8,000 mijë të masakruar në vend dhe rreth 3,000 të vdekur maleve e luginave nga vështirësitë e rrugës për në shtetin shqiptar) si dhe rreth 50,000 mijë të dëbuar të cilët u larguan nga vatrat e veta për të mos

u kthyer kurrë më atje. Përfundimi i operacioneve të ushtrisë greke ndaj elementit etnik shqiptar në Çamëri e spastroi përfundimisht zonën veriperëndimore të Greqisë nga shqiptarët autoktonë. Kështu u çuan në vend porositë e etërve themelues të shtetit grek të re të siguruar kufinj e veriut me Shqipërinë dhe për të pasur dorë të lirë për të depërtuar më lehtë në vetë Shqipërinë e vogël të 1912, në një fazë të re të marrëdhënieve kuptohet. Çdo vit organizohen aktivitete përkujtimore si dhe ndërmerret një marshim masiv deri në kufi me Greqinë në Qafë Botë për të përkujtuar viktimat e terrorizmit grek. Por ende çështja çame...

faqe 16-17



Tri histori arbëreshe nga Barile dhe Shën Pali shqiptar

Aventurë, histori, dhe rite... kjo është hapësira e kësaj jave, mjaft interesante nga bota e arbëreshëve të Bazilikatës

"Toka jonë" e Perikli Çulit, mos e hiqni monumentin

Po mëtojnë ta zhvendosin nga qendra e qytetit diku gjetkë duke dashur të plotësojnë dëshirën e ndonjë individi. Por ai është emblema, është karta e identitetit të Qytetit...

Nga Faslli Haliti

E kam dashur qytetin tim siç ka qenë në fëmijërinë, në rininë time, por unë e dua edhe tani atë, kur unë jam thinjur dhe ai edhe pse i moshuar më shumë se unë, sepse është edhe më i lashtë se gjyshi dhe stërgjyshërit e mi, qyteti im prapë mbetet rinor e përtërihet çdo vit e më shumë. E kam parë në fëmijëri qytetin tim të rrethuar me mullarë, me gardhe të thurura e ferra, me Hotelin e Taq Spiros si një perle në qendër të tij, me vargun e harkuar të ndërtesave me arkitekturë të përkryer: ndërtesa me ballkon të bukur, ku mbaheshin fjalime gjatë

pushtimit e në vitet e para të Çlirimit, pas kësaj godine vazhdonin me radhë, klubi Dinamo, siç quhej atëherë, posta dhe vazhdonin dyqane më të ulët deri në fund të shehshit, ku ka qenë pasticëria dikur; varg ndërtesash të cilat u prishën në mënyrë kriminale dhe injorante në fillim e në vazhdim të vitet'50-60-të nga pushtetarë axhami. E kam parë qytetin tim edhe me Teqen e Lekës në qoshen e Mapos, ku shiteshin çerturina, me pazarin e gjësë së trashë që bëhej ditëve të hëna gjatë Luftës e pas Çlirimit, deri në fillim të viteve pesëdhjetë, pikërisht aty ku është sot Pallati i Kulturës Vaçe Zela; me pazarin e drithërave në sheshin prapa Teqes së...

faqe 20

KUNDËRSHTARËT | E GJUHËS

DOSJA PEKMEZI NE VJENE

Përplasjet me Gurakuqin,
Konicën, dhe kryekonsullin Kral

Nga Pjeter Logoreci

vijon nga faqja 13

...kjo ra në sy dhe të vetë Kryekonsullit Austriak në Shkodër Kral, i cili ishte ndër nxitësit kryesor për krijimin e Komisionit nga Fishta e Gurakuqi. Konsulli Kral në korespondencën e tij, njoftonte Vjenën për kontraditën në mes anëtarëve të kryesisë me Pekmezit dhe i kërkonte Ministrisë rishikimin e emnimit të tij. Kjo sollë dhe një farë distancimi konfliktual në mes të dërguemit nga Vjena në krye të Komisionit Pekmezit dhe Konsullit të përgjithshëm Kral. Në një takim në mes bashkëatdhetarësh në Vjenë, Pekmezi ankohej për Konsullin Kral si i njëanshëm dhe i mvarun ekonomikisht nga disa anëtarë të komisionit. Ma poshtë po sjell një letër e cila mban datën Shkodër 18 tetor 1917, që Konsulli Kral ja drejton Ministrisë të jashtëm Graf Czernin në Vjenë, ku shkruhet për pakënaqësitë që ai ka nga puna e Pekmezit dhe thashëthemet që ai përhapë në mes të shqiptarëve.

Graf Czernin/ Eien
Nr. 199.
Skutari, me 18.Okt. 1917
Akuzat e Dr. Pekmezit

Njoftohet që Korpskomandoja me një mbishkrim që i bashkangjitet kësaj letre ka lejuar që, me një fare Omer Hamid Gynokastra nga Berati të mbahet një proces verbal pyetjesh për të sqaruar, nëse Dr. Pekmezi në të vërtetë, përballë disa personave në Vjenë, ka vu në dyshim pastertinë e karakterit tim. Nga ky mbishkrim ishin prekë thellë (mësa kuptova unë) Inspektori i arsimit Matias Logoreci dhe sekretari i Drejtorisë kombëtare të arsimit Anton Paluca të cilëve mjeku kshilltar i ma sipërm ja kishte treguar, dhe që u ndien të fyer gjithashtu nga fjalët e Pekmezit....

Motivi i shpifjes së Pekmezit është mendimi i tij i gabuem, që ishte në doren time ta ndihmoja që këndveshtrimet e tij në Komisionin Letrare Shqiptare në çdo mënyrë të ishin fituese. Edhe pse unë gjithmonë pikëpamjet e tij i kam miratuar objektivisht, përkundër një opozite të fuqishme në Komision, të cilën ai e ashpërsoj nëpërmes veprimesh të papërshtatëshme dhe aftësive të tij dukshëm të kufizime, por që, me keqardhje, vetëm në pak raste nuk muja ta mbështes.

Megjithatë unë, siq kam sqaruar edhe në pergjigjen e drejtuar Korpskomandos, nuk kam asnjë ndjenjë armiqësore, apo fyerje kundër tij. Si privatperson do ta kisha mosperfillë çdo atakim të tij sa qesharak aq dhe të çmendur për këdo që e ndigjon. Por nga pozicioni më i lartë ushtarak që unë mbaj dhe si funksionar civil në Shqipëri, nuk më mbetë zgjidhje tjetër veçse të sjell në dritë të vërtetë të gjitha anët e problemit.....

Mbas këtij dokumenti informativ të Konsullit Kral që u protokollue me 19 Okt. 1917 në Ministrinë e jashtme në Vjenë, vjen një tjetër dokument, por kësaj radhe nga Pekmezi i cili me kërkesën e Konsullit

Motivi i shpifjes së Pekmezit është mendimi i tij i gabuem, që ishte në doren time ta ndihmoja që këndveshtrimet e tij në Komisionin Letrare Shqiptare në çdo mënyrë të ishin fituese. Edhe pse unë gjithmonë pikëpamjet e tij i kam miratuar objektivisht, përkundër një opozite të fuqishme në Komision, të cilën ai e ashpërsoj nëpërmes veprimesh të papërshtatëshme dhe aftësive të tij dukshëm të kufizime, por që, me keqardhje, vetëm në pak raste nuk muja ta mbështes



Në foto: Gjergj Pekmezi

Kral është pyetur nga dy ushtarakë të natës të autorizuem nga shteti austriak, Majori Spindler dhe Hauptmann Marcic. Ky procesverbal mban adresën e Konsullit të përgjithshëm August von Kral dhe ka datën: Shkodër me 20 Oktober 1917.

Ktu po sjell në shqip tekstin e letrës:

Sqarim

Sot më është ba e dijtun nëpërmjet Ma-

ajorit Spindler dhe Hauptmann Marcic, të dy të autorizuar nga Konsulli i përgjithshëm Kral, që gjatë një bisede në Vjenë në një Kafene, para disa dëshmitarëve, kam fajsuar Konsullin e përgjithshëm Kral, që është komprometue duke marrë një sasi argjendi si rushfet, me vlerën e të cilit ka shku në një kamp pushimi.


Unë sqaroj këtu se kjo akuzë është e pa vërtetë. Një gjë të tillë nuk e kam thënë kurrë. E vërteta është si vijon: meqë unë

në verë isha për pushime në Vjenë, takova atje zotni Azis Pashë Vrionin me të birin, të cilët kishin ardhur për të ba operacion. Me që Azis Pasha nuk fliste gjermanisht kishte marrë me vehte Dr. Omerin nga Berati si shoqëues.

Në Vjenë Azis Pasha u bashkue me Faik Bey Konicën një i njohtun i tij i vjetër, i cili njihet kudo për Excentritetin (sjelle të çuditëshme) e tij, që i shoqeruem edhe me Dr. Omerin të dy së bashku me

Komisia Letrare Shqipe dhe dorëheqja e Gjergj Pekmezit

Në foto: Faksimile e letrës që Konsulli Kral ja drejton Ministrit të jashtëm Graf Czernin në Vjenë, ku shkruhet për pakënaqësi të ai ka nga puna e Pekmezit.



takuan mua disa herë për arsye të ndryshme, ku përherë ngacmojshin Azis Pashën. Dr. Omeri duhej me shoqne të birin e Azis Pashës në Karlsbad, e mbasi Azis Pashës nuk i pëlqente më Dr. Omeri, kërkoj prej mejet një shoqënie tjetër për të birin. Kjo bani që Dr. Omer dhe Faik Bey Konica u kthyen kundër mejet.

Nga kjo mendoj unë, me siguri që të dy zotnijtë e fyer vendosën që të hakmerren kundër mejet duke më akuzu për gjana qi unë kurr nuk i kam thanë. Në këto rrethana ju lutem që të pyetni Azis Pashën, djalin e tij dhe studentin e mjekësisë që i sherbej, Johann Bascho, e po ashtu edhe zotni Feizi Bey Alizotin i cili u informue nga Azis Pasha sapo ky u kthy në Berat. Unë deklaroj edhe një herë që kurr nuk kam ba të tilla deklarata që prekun nderin e Konsullit të përgjithshëm Kral, gjë për të cilën mund të be-tohem.

Për të plotësue të gjithë panoramën e ngjarjes me objektivitet dhe që të jetë sa ma e qartë për lexuesin, për të nxjerrë vetë konkluzionin e këtij konflikti, po vendos në këtë shkrim edhe procesverbalin e pyetjeje së një prej dëshmitarëve kryesorë, Dr. Omer Hamid Gjinokastrja nga Berati.


Protokoll, datë 18 shtator 1917 i mbajtur me Dr. Omer Hamid Gjinokastrja në Berat. Personat e autorizuar për hetim: Gjeneralmajor Franz Ritter Eieiss - Tihany, komandant i rrethit Berat, si dhe Dr. Guido Mück, Referentjuridik dhe mbajtës i protokollit. I pyetur i fill vetë gjermanisht (nuk ka nevojë për përkthyes).

Dr. Omer Hamid Gjinokastrja, lindë dhe rritë në Gjirokastrë, mjek i përgjithshëm në Berat, 30 vjeç.

Në verën e 1917, në qershor ose korrik isha i ulun në një kafe në Alserhof në Vjenë. Me mue ishte edhe Faik Bey Konica, shkrimtar që banon në Vjenë.....për ma tepër ishte aty edhe Dr. Pekmezi dhe disa burra të tjerë prej Shqypnie që nuk më kujtohen ma se kush ishin. Ndoshta ishte edhe Fazdi Bey Frashëri me ne. Ky është student në Vjenë e Faik Bey Konica e njeh. Këtu në kafe përpara të gjithëve, Dr. Pekmezi ka folë gjana të cilat unë më vonë, ja kam tregue Drejtorit kombëtar të arsimit Luigj Gurakuqit.

Këto deklarata ishin që Komisari civil von Kral përpiqet të përfillojë për nevojat personale monedha argjendit e këto lëvizje të gjitha me ndërmjetësinë e Drejtorit Kombëtar të Finanzave Fejzi Bey Alizotin. Rreth kësaj, tha ai (Pekmezi) në kto pëllëqe i përziem asht edhe Drejtori i përgjithshëm i arsimit Gurakuqi. A janë për mend këtu edhe emna të tjerë si Logoreci e Paluca nuk mundem me kujtue.

Dr. Pekmezi shtoj më mbrapa që zotnia von Kral jeton me kto monedha të pista në Badgastein në një lëndinë luksoze.....



Në foto: (Lart) Faksimile të sqarimit të Pekmezit, i cili me kërkesën e Konsullit Kral është pyetur nga dy ushtarakë të autorizuar nga shteti austriak, Majori Spindler dhe Hauptmann Marcic. (poshtë) Faksimile e procesverbalit të pyetjeje të një prej dëshmitarëve kryesorë, Dr. Omer Hamid Gjinokastrja nga Berati

dëshmi e gjithë dosja prej shumë faqesh (procesverbalet e pyetjeje edhe të dëshmitarëve të tjerë me po të njëjtat deklarata), njihet në arkivin e ministrisë së jashtme si:

AFFÄRE PEKMEZI.

Në dosje janë dhe disa raporte dhe informacione për problemet personale e familjare të Pekmezit, të cilat e shqetsonin atë personalisht, por edhe dëshirin e tij për punë e të gjithë klimën në Komisionin Letrare.

Si rrjedhojë mendoj se këto konflikte ishin shkaku që ai të largohej nga Komisia Letrare e nga Shkodra ku situata për te u ba padurueshme. Momente të tjera nga jeta e tij në Vjenë nuk janë të pasqyrueme në këtë dosje. Dihet që ai pat një rol të madh në krijimin e katedrës së gjuhës shqipe në Vjenë, shkroj libra mbi studime gramatikore që sipas specialistëve janë kulmore për nga trajtimi dhe zhvillimi i gjuhës shqipe, si dhe perfaqësoj der jesisht vendin në karrieren e tij si diplomat. Duhet përmendë se gjatë periudhës së protektoratit austriak në Ballkan, Pekmezi u mbeshtet fuqishëm financiarisht me fonde për të mbajtur në kambë aktivitetet e tij letrare, gjuhësore, gazetat, shoqatën, për botimin e librave që dërgoheshin në atdhe. Në botën e shqiptarëve të Austrisë ai ishte një nga figurat kryesore që i dha tonin jetës patriotike të emigrantëve jashtë atdheut.

Shënim:

Materialet e paraqituna në këtë shkrim gjenden në AT/OESTA/HHSTA, Diplomatie und Außenpolitik 1848-1918

Duke u nisur nga këto dokumenta dhe

Wien, me 27 qeshor 2012

